



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm për Punën dhe Çështjet Sociale

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 2 datë 24.07.2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 7 datë 11/07/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike, duke përdorur 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit Qershor 2025"

Analiza ligjore: Projekt vendimi është në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligji nr 57/2019, date 18.07.2019 "Per Asistences Sociale ne Republiken e Shqiperise", VKM Nr. 597, datë 04.09.2019, "Për përcaktiminin e procedurave te dokumentacionit dhe te masës mujore të përfitimit të ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike"; Mbi zbatimin e vendimit Nr. 597, date 04.09.2019, "Për përcaktiminin e procedurave te dokumentacionit dhe te masës mujore te përfitimit te Ndhimes Ekonomike"; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 07, datë 25.02.2025, Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit të ndihmës ekonomike" VKM nr.8 dt.14.01.2015 "Per mbrojtjen e shtesave ne nevojë per efekt te heqjes se fashos se konsumit te energjiëse elektrike deri ne 300 Kwh ne muaj".

Situata aktuale dhe financiare e funksionit:

Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social pas verifikimeve të kryera në familje dhe përllogaritjes së fondit 6% të ndihmës ekonomike rekomandoi 30 familje me fond 101.743 lekë.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Çështjeve Sociale ka relatuar përpara komisionit për Projekt vendimin

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni për punën dhe çështjet sociale dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë Çështjeve Sociale.

Impakti social / grupet që preken: Projekti impakton jetën e të gjitha shtresave, kategorive të varfra në të gjithë territorin e Bashkisë Pukë

A është objekt i konsultimit publik: Nuk është objekt konsultimi me publikun

Komisioni për Sherbime Publike dhe Prona, i mbledhur me datën 24.07. 2025, shqyrtoi projekt vendimit nr. 7 datë 11/07/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike, duke përdorur 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit Qershor 2025" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Kryetar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Dhimitër Asani

Sekretar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

ALFONS

GJERGJAJ

Datë 24.07. 2025